VENDIM
Nr. 150, datë 10.6.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "DANSKE COMMODITIES ALBANIA" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "e"; pika 5, pika 1 germa "e"; 13, nenit 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 900/2 prot., datë 9.6.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Danske Commodities Albania' sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 19.5.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 374, seria T17, të shoqërisë "Danske Commodities Albania" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 70/19 prot., datë 20.5.2022, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.6.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim – neni 9, pika 1, germat "a", "b" dhe "c";

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor – neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e".

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germat "b", "c" dhe "d".

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike – neni 9, pika 4.8, germat "a", "b" dhe "d".

- Në lidhje me Dokumentacionin financiar dhe fiskal – neni 9, pika 3, germa "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), i cili është konsideruar i plotësuar pjesërisht pasi shoqëria rezulton në një proces apelimi të disa gjobave mbi tatimin mbi fitim dhe tatim mbi vlerën e shtuar, vlerësohet t'i lihet si kusht në vendimin e rinovimit të licencës shoqërisë "Danske Commodities Albania" sh.p.k., që në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.

- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë "Danske Commodities Albania" sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 4.7.2022.

2. Shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k. në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE, vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të vendimmarrjes së organit tatimor në përfundim të procesit të vlerësimit mbi procesin e apelimit të nisur nga shoqëria "Danske Commodities Albania" sh.p.k., që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimmarrjeje.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti